



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:256362
Datë: 13.05.2024
Numri i dokumentit: 05676352

C.nr.926/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren individuale Erolinda Uka-Sadiku, procesmbajtësen Laureta Alimehaj, në çështjen juridiko-civile të paditësit Sh.M nga P, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Z.A me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës S.M-Z, nga Mitrovica të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati R.K me seli në Mitrovicë, me objekt kontesti anulimin e kontratës për mbajtje të përjetshme nr.364/89 e lidhur me datën 02.10.1989 për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme dhe vërtetimin e pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, e publik, me datën 13.05.2024 hartoi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit Sh.M nga P, me të cilën ka kërkuar që të anulohet kontrata për mbajtjen e përjetshme nr. 364/89 e lidhur me datën 02.10.1989 në mes të H.M dhe S.M për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme dhe vërtetohet se paditësi Sh.M është pronar me ½ pjesë ideale në paluajtshmërinë- ngastrën kadastrale UL-7108072-00027 në sipërfaqe prej 148 m² ZK M, si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 1762 euro.
- II. SHFUQIZOHET** masa e sigurisë e caktuar me Aktvendimin C.nr.129/11 të datës 21.02.2012, me të cilin kundërshtares së sigurimit S M nga M i është ndaluar ngarkimi (vuarja në hiptokë) dhe shitjen e paluatjshmërisë sipas certifikatës P-71208072-2.
- III. GARANCIA** në shumë prej 6.000 euro (gjashtë mijë euro) i kthehet paditësit në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimit.
- IV.** Ky aktgjykim shërben si bazë për fshirjen e masës së sigurisë së shfuqizuar në pikën II të dispozitivit në Zyrën e Regjistrit Kadastrale në Komunën e M J.

- V. **OBLIGOHET** paditësi që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguajë të paditurës shumën në lartësi prej 1,822.05 euro në afat prej 15 ditësh pas pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin për përmbarrim të dhunshëm.
- VI. **REFUZHET** pjesërisht kërkesa e të paditurës për kompensimin e shpenzimeve procedurale përtej shumës së aprovuar si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, prej 672.5 euro si e pabazuar.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij avokatit Z. A, me seli në M, pranë kësaj gjykate me datën 28.06.2011, ka parashtruar padinë të cilën e ka precizuar me datën 29.01.2024, kundër të paditurës S. M, me të cilën ka kërkuar që të anulohet kontrata për mbajtjen e përjetshme nr. 364/89 e lidhur me datën 02.10.1989 në mes të marrësit të ushqimit H M dhe dhënëses së ushqimit S. M për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme dhe ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi Sh M është pronar me ½ pjesë ideale në paluajtshmërinë- ngastrën kadastrale UL-7108072-00027 në sipërfaqe prej 148 m² ZK M.

Rrjedha e procedurës

Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktvendimin C.nr.129/2011 të datës 21.02.2012 ia ka ndaluar kundërshtares së sigurimit S.M që ta ngarkojë dhe tjetërsojë paluajtshmërinë P-71208072-2 deri në përfundimin e zgjidhjes së çështjes kryesore.

Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktvendimin C.nr. 1075/19 të datës 02.02.2021, ka hedhur si të pasafatshme padinë e paditësit Sh M nga P të ushtruar kundër të paditurës S M- Z për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme dhe për reduktimin e kontratës për mbajtje të përjetshme.

Në pikën e dytë të dispozitivit të aktvendimit ka vendosur që padia e paditësve B.M, B.M, V.M, N.M dhe B.M për shkak cënimit të pjesës së domosdoshme dhe reduktimin e Kontratës për mbajtje të përjetshme konsiderohet se është tërhequr.

I autorizuari i paditësit ndaj aktvendimit C.nr. 1075/19 të datës 02.02.2021, ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të LPK-së , vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të ligjit material.

Gjykata e Apelit, me aktvendimin AC.nr.3320/21, të datës 08.06.2021, ka aprovuar si të bazuar ankesën e të autoizuarit të paditësit dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim për pikën e parë të dispozitivit sa i përket paditësit Sh.M, ndërsa pikën e dytë të dispozitivit nuk e ka shqyrtuar.

Juridiksioni i gjykatës

Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështjeje dhe bazuar në nenin 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), por edhe me dispozitat e LMD, më saktësisht nenit, konstatoi

se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykatë është kompetente për të vendosur këtë çështje.

Lidhur me kompetencën lëndore, në bazë nenin 17.2 të LPK-së: “Vlerësimi i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykata”. Meqenëse ndodhemi përpara një kontesti me karakter civil që rrjedh nga marrëdhënia kontraktuale, gjykata çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Lidhur me kompetencën territoriale në bazë të nenit 41 të LPK-së: i cili përcakton se “Për gjykim në kontestet lidhur me pronësinë dhe të drejtat sendore të tjera mbi sendet e paluajtshme, në kontestet për shkak të pengim posedimit mbi sendin e paluajtshëm, si dhe në kontestet nga raportet e qiradhënies së paluajtshmërisë, ose nga kontratat për shfrytëzimin e banesave apo të l”. Duke qenë se kontrata për mbajtjen e përjetshme është lidhur në Mitrovicë si dhe paluajtshmëria e cila është objekt i kontratës UL-7108072-00027 në sipërfaqe prej 148 m² shtrihet në zonën kadastrale në Mitrovicë, rezultoi se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje civile është kjo gjykatë.

Pala paditëse, legjitimohet t’i drejtohet gjykatës me këtë padi pasi pretendon se me lidhjen e kontratës për mbajtje të përjetshme në mes të babait të tij tashmë të ndjerë me të paditurën motrën e tij i është cënuar pjesë e domosdoshme në trashëgiminë e parcelës UL-7108072-00027 në sipërfaqe prej 148 m², ndërsa pala e paditur ka legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike pasi si dhënëse e ushqimit ka lidhur kontratën për mbajtjen e përjetshme me dhënësin e ushqimit babain e saj e që pas vdekjes së të atit e njëjta ka fituar pronësinë në ngastrën kadastrale UL-7108072-00027 në sipërfaqe prej 148 m², në të cilën paditësi kërkon që të shpallet pronarë me ½ pjesë ideale.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të nenit 67 të LPK-së, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palët prezent në gjykim.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

I autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare deklaroi se konfrom provave të nxjerra në procedurën provuese konsideroj se në mënyrë të pakontestueshme u vërtetua bazueshmëria e padisë dhe kërkesëpadisë veçanërisht konstatuar dhe precizuar me parashtrësën e datës 29.01.2024, me të cilën pala paditëse I propozon gjykatës ta anulojë kontratën për mbajtjen e përjetshme për faktin se e njëjta gjykatës nuk iu prezantua në origjinal por edhe nga fotokopja shihet se e njëjta nuk është e nënshkruar nga gjyqtarja dhe procesmbajtësja kjo është arsyeja e parë dhe arsyeja tjetër me para supozim se e njëjta është valide duhet anuluar pasi që përmbaron element të cilat të njëjtën e cilëson nule pasi që me të njëjtën është cënuar pjesa e domosdoshme me të cilën pronari por edhe trashëgimlënësi nuk mund të dispozojnë në mënyrë të lirshme kjo conform neneit 30 dhe 31 të Ligjit mbi Trashëgiminë, i cili parasheh se: “*Trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë në pasurin më të cilin trashëgimlënësi nuk mund të disponoj dhe e cila quhet pjesë e domosdoshme*”.

Duke u nisur nga ky fakt dhe fakti tjetër se paditësit por edhe trashëgimtareve tjerë me asnjë vendim të plotfuqishme nuk ju ka marr e drejta në trashëgimi atëherë vlerësoj se babi i palëve ndërgjyqësve nuk ka mundur dhe nuk ka pasur të drejtë që tërë pasurin e tij t'ia lëjë vetëm një fëmijë, pavarësisht me çfarë vendimi apo kontrate e cila pra supozim se është (valide) ndërsa bazuar në parimet e të drejtës reale që derivon nga e drejta në pronë e cila asnjëherë nuk parashkruhet-vjetërsohet, marrësi i mbajtjes nuk ka mundur në këtë mënyrë “ti përjashtoj” trashëgimtarët e tij të rendit të I e që janë fëmijët e tij.

Bazuar në këto fakte kjo kontratë duhet anuluar dhe se raporti eventual i krijuar me të njëjtën megjithatë nuk mund të konsiderohet raport obligativ sic parasheh kontrata mbi mbajtjen e përjetshme e bazuar nga të thënat e më lartcekura se kemi të bëjmë pronën –pjesën e domosdoshme me të cilën babi i tyre nuk ka mundur të disponoj.

Propozimi për sjelljen e aktgjykimit që paditësi të shpallët pronar me ½ të pjesës ideale të ngastrës katastrale që është objekt shqyrtimi e determinon fakti se pasi që fëmijë të tjerë e veçanërisht trashëgimtarët e F.M me aktvendimin e kësaj gjykatë me procesverbalin e datës 29.10.2020 padia dhe kërkesëpadi e tyre në mënyrë të plotfuqishme është konsideruar e tërhequr, andaj duke u nisur nga fakti se kemi të bëjmë me një procedurë “Puro” të pastër kontestimore e drejtë e ndërgjyqësve është të kërkojnë realizimin përkatësisht mbrojtjen e të drejtave pronësore-juridike dhe e drejtë e çdo trashëgimtari është që të kërkojë eventualisht të pranojë një pjesë të trashëgimisë eventualisht të heç dorë në emër të dikujt, por si në rastin konkret siç kanë vepruar trashëgimtarët e F.M por edhe e bija e H.M të njëjtit nuk kanë dëshirua që të marrin pjesë në pasuri e cila ju takon pas vdekjes së babait të tyre.

Nga deklaratat e paditësit të dëgjuar si palë pastaj nga deklarata e dëshmitarit A. M por në një pjesë edhe nga deklarata e vetë të paditurës vërtetohet fakti se për përkujdesjen ndaj prindit të tyre H.M kush më shumë e kush më pak i kanë kushtuar babait të tyre, nisur nga fakti se paditësi është me profesion mjek por se ka qëndruar mirë materialisht i njëjti ka kontribuar në këtë drejtim, (bile në deklaratën e tij dëshmitari A. M-bashkë familjari ka deklaruar se disa herë Sh e ka marrë me veturën e tij babin e tij H.M dhe e ka dërguar në shtëpinë e vikendit afër liqenit të ..).

Andaj duke u nisur nga faktet e pa mohueshme del se të gjithë trashëgimtarët e H.M por këtu duhet cekur edhe faktin se paditësi në asnjë mënyrë nuk ka hequr dorë nga e drejta dhe trashëgimi përkatësisht në atë pjesë që i takon pas vdekjes së babit të tij, fakt ky që i jep të drejtë morale por edhe ligjore bazuar në ligjet e cekura më lartë i njëjti kërkon që këtë të drejtë ta realizoj në këtë procedurë dhe që ti njihet e drejta e pronës në pasurin e babit të tij, andaj gjykatës i propozoj dhe konsideroj se në mënyrë të saktë është vërtetuar bazueshmëria e kërkesëpadisë andaj i propozoj që më aktgjykim të vendosë si në fillimin e fjalës përfundimtare. Shpenzimet procedurale i kërkoj për 10 seanca të mbajtura shumë prej 135 euro 1 seancë e shtyrë si dhe shumë prej 208 euro për ankesë, dt. 05.03.2021, shumë prej 104 euro për padinë të dt. 21.06.2021, shumë për taksë në emër të ankesës shumë prej 30 euro ose gjithsej shumë prej 1762 euro.

I autorizuari të paditurës në fjalën përfundimare deklaroi se që në fillimin dua të potencoj se “Lex Specialis derogat lex generalis” e me këtë ju bëj me dije se paditësi Sh.M edhe sa ka qenë gjallë H.M ka ditë për ekzistimin e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme nr264/1989 të datës 02.10.1989.

Ai me veprimet e tija subjektive nga data 24.04.1996 objektivisht len të kuptohet se nuk ka qenë i interesuar për trashëgimi sepse siç potencoj edhe kolegu në fjalën përfundimtare “ka qenë i gjendjes së mirë materiale”.

Paditësi nuk ka qenë i varur nga babai sepse ka afaru dhe afaron si mjek, ai ka lëshuar afatin prej (3vjetësh) që të kërkoj anulimin e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme në mesë të babait të tij dhe motrës së tij tani të së paditurës.

Drejtë është vepruar në procedurën e mëparshme kur i është hedhe poshtë padia paditësit si e pa lejuar sepse nga data e 24.04.1996 e gjerë më datën 28.06.2011 ka kaluar periudha kohore mbi tre vjeçare si afat prekluziv për kontestimin e padisë.

Se e paditura i ka vepruar me ndërgjegje fletë edhe fakti se edhe sistemi i kaluar juridik e ka pranuar këtë të drejtë pasi që parimet themelore si para lufte ashtu edhe pas lufte janë të njejta mos të them identike.

Ne në shqyrtimin paraprak dhamë vërejte në deklarinimin e paditësit sepse ajo fare nuk ishte e vertetë dhe se për vdekjen e H i informuat motrat. Ai nuk është kujdesur për babanë është kujdesur tani e paditura, motra Q si dhe fëmijët e saj.

Individi më objektiv në këtë çështje juridike civile është Q.M-S e cila në mënyrë të qartë dhe besnike dha deklaratë në këtë gjykatë dhe bindshëm foli për faktin se a diti apo nuk diti paditësi për ekzistimin e kontratës-tani kontestuese nga paditësi.

Nuk përkon me të vërtetën deklarimi i paditësi se gjoja kontrata N.nr264/89 e datës 02.10.1989 nuk është nënshkruar nga gjyqtarja S.R dhe procesmbajtësia M.V, kur në fund të kontratës është shkruar teksti “saktësinë e dërgesës e vërteton” ku gjendet një nënshkrim i referentit në shkrimoren civile dhe vula e gjykatës.

Se është kështu si gjyqtarja po ashtu edhe procesmbajtësja kanë konstatuar “dora-vet” dhe një origjinal i është dhënë tani të së paditurës të cilën ajo e ka përdorur gjatë muajit korrik të vitit 1996 kur drejtorit për të ardhura shoqërore në Mitrovicë- katastrit komunal Mitrovicë ka aplikuar për ndërrim të titullarit, lutja është aprovuar është pruar aktvendimi adekuat dhe që nga ajo kohë, pra nga viti 1996 e jo nga viti 2011, e paditura është titullar e pronësisë kontestuese.

Paditësi e ka humbur të drejtën për ta trashëguar pjesën e domosdoshme pasi që para datës 24.04.1996 ka ditur për kontratën mbi mbajtjen e përjetshme në mes dekujusit dhe këtu të paditurës por nuk ka reaguuar e me këtë vendim subjektiv objektivisht ka bërë me dije se nuk e konteston kontratën mbi mbajtjen e përjetshme N.nr.264/1989 të datës 02.10.1989. Se është kështu vërtetojnë dëshmitarja motra e ndërgjyqësve Q.M S e cila para noterit K.M ka dhënë

deklaratë se “ për nënshkrimin e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme babaina ka informuar mua, F, Sh por asnjëri nuk ka qenë kundër sepse ishim në gjendje të mirë financiare dhe I kishim familjet tona, edhe e paditura shprehet se gjersa i ati ishte në jetë pasardhësit e tij janë informuar për ekzistimin e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme por nuk e kanë kundërshtuar të njëjtën. Paditësi nuk është I gjendjes së rrënuar materiale sepse ka banesë në M rrugën ..., vikend-shtëpi në fshati Z Komuna e T, ka banesë në Lodër,ka banesë e ordinancë private të akupunturës në P. dhe gëzon pensionin e Mbretërisë së Bashkuar –Londër dhe Republikës s së Kosovës.

Gjyktës I dorëzoi edhe aktvendimin e Shërbimit të ardhurave shoqërore- Mitrovicë të paraluftës sipas së cilit e paditura edhe para luftime të vitit 1999 u regjistrua si pronare ligjore e patundshmërisë që shtihet në ngastrën kadastrale P-71208072-00572-2 në sipërfaqe prej 148 m2 por me ikjen e pushtetit të Serbisë ky regjistrim I të paditurës si titullare humbi dhe nuk u kthye më në Zyrën Kadastrale Komunale në Mitrovcië. Andaj I propozoj gjykatës që kërkesëpadinë për anulimin e kontratës ta refuzojë si të pabazaur dhe ta shfuqizojë masën e sigurisë të caktuar me aktvendimin C.nr.129/2011 të datës 21.02.2012 mbi ndalimin e tjetërsimit të pronës së paluajtshme në njësinë kadastrale.

Shpenzimet e procedurës I kërkoi në shumë totale prej 2.495 euro dhe atë për parashtresën e datës 26.10.2011 50% në shumë prej 67.50 euro, shqyrtimin e datës 03.11.2011 50% në shumë prej 67.50 euro, shqyrtimin e datës 29.11.2011 në shumë prej 135.00 euro, shqyrtimin e datës 21.02.2012 në shumë prej 135.00 euro, shqyrtimin e datës 29.10.2013 50 % në shumë prej 67.50 euro, shqyrtimin e datës 05.12.2013 në shumë prej 135.00 euro, shqyrtimin e datës 20.12.2016 në shumë prej 135.00 euro, shqyrtimin e datës 14.09.2017 në shumë prej 135.00 euro, shqyrtimin e datës 18.04.2018 në shumë prej 135.00 euro, shqyrtimin e datës 11.12.2019 në shumë prej 135.00 euro, shqyrtimin e datës 29.10.2020 në shumë prej 135.00 euro, shqyrtimin e datës 18.11.2020 në shumë prej 135.00 euro, shqyrtimin e datës 09.02.2024 në shumë prej 135.00 euro, shqyrtimin e datës 22.03.2024 në shumë prej 135.00 euro, shqyrtimin e datës 27.03.2024 në shumë prej 135.00 euro.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike në shqyrtimin gjyqësor administroi provat si në vijim: kopja e letërnjoftimit për S. M, Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e lidhur me datën 15.10.1960 në mes M.R dhe H.M, Kontrata mbi Mbajtjen e Përjetshme nr.264/89 e datës 02.10.1989 e lidhur mes H.M dhe S.M, aktvendimi i gjykatës komunale në Mitrovicë me nr.T.nr.83/2003 i datës 23.05.2003, mirënjohja e shoqatës së veteranëve të arsimit për H.M. Deklarata e dëshmitares Q.M dhënë në seancën e datës 14.09.2017, deklarata e dëshmitarit A.M dhënë në seancën e datës 18.11.2020, certifikata e vdekjes së F.M me nr rendor 218, certifikata e pronësisë nr.P-71208072-00027, certifikata e lindjes për S.M me nr rendor 196 e lëshuar me datën 22.03.2024, ekstrakti i gjendjes civile për paditësin Sh.M lëshuar me datën 22.03.2024, certifikata e vdekjes me nr. reference 114/2011, fototgrafia e përmendores së varrit të H.M, kërkesa e të paditurës e datës 03.06.1996, Aktvendimi me nr.464-1720 dt.02.07.1996, fletëpagesat e vitit 1996, deklarata e Q.S dt.06.09.2013, deklarata e paditësit dhënë në cilësinë e

palës me datën 21.03.2024, deklarata e të paditurës në cilësinë e të paditurës dhënë në seancën e datës 21.03.2024.

Gjykata pas vlerësimit të deklaramëve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Faktet

Nga leximi i ekstraktit të lindjes për paditësin Sh.M, me serik E 27805847, e lëshuar me datën 22.03.2024, vërtetohet se i njëjti ka lindur me datën 30.10.1939 në V nga babai H.M dhe nëna M.M

Nga leximi i çertifikatës së lindjes për të paditurën S.M, me numër rendor 196, numër të referencës 27/1948RL/27001, vërtetohet fakti se ka lindur me datën 14.01.1948 në V, nga babai H.M dhe nëna M.M.

Nga leximi i çertifikatës së vdekjes me numër rendor 114/2011, vërtetohet fakti se H.M, la lindur me datën 15.04.1914 në Mitrovicë ndërsa ka vdekur me datën 24.04.1996 në Mitrovicë.

Nga leximi i kontratës për shitblerjen e lidhur me datën 15.10.1960, në Mitrovicë në mes të M. R dhe H.M, vërtetohet fakti se shitësi M.R ia ka shitur parcelën nr.578, nr. i planit 73/77, 80 dhe 81 blerësit H.M me çmim prej 750.000 dinarë, e legalizuar në gjykatë sipas nr të lëgut ov.980/60,e legalizuar në Gjykatën e Mitrovicës me nr.264/89 me datën 02.10.1989.

Nga leximi i kontratës për mbajtjen e përjetshme të lidhur mes H.M si marrës i ushqimit dhe S.M si dhënëse e ushqimit, në M rrugën ... në pikën e parë të kësaj kontrate rezulton se kontraktuesi H.M nga babai S është person në moshe dhe i pa aftë për punë ka pranuar që kontraktuesja S.M ta mbajë atë përjetësisht në atë mënyrë që do ti sigurojë ushqim, veshmbathje, dru për nxehe dhe në rast të sëmundjes do ta trajtoj do ti bartë shpenzimet e transportit, shërimit dhe të tjerat hapësirat do ti mbajë të pastëra, në rast të vdekjes sipas zakonet dhe do ti ngrisë prmendoren dhe do ti respektojë zakonet e varrimit.

Ndërsa në pikën e dytë të kësaj kontrate rezulton se dhënësjja e ushqimit S.M, pranon obligimin që kontraktuesi H.M si marrës i mbajtjes ti ofrojë mbajtje si në pikën e parë të dispozitivit të kontratës, ndërsa në pikën e tretë të kontratës rezulton se marrësi i mbajtjes H.M si kompnësim për mbajtje ia lë pronën në disponim të lirë dhënëses së ushqimit S.M pronën në parcelën kadastrale 578/2 sipas listës poseduese nr.37 zonë kadastrale të Mitrovicës.

Në pikën katër të kësaj kontrate rezulton se pronësinë e parcelës 578/2 dhënësjja e ushqimit S.M do ta regjistrojë në emër të saj pas vdekjes së marrësit të ushqimit.

Nga leximi i kërkesës për regjistrimin e pronës së datës 03.06.1996, rezulton se e paditura me datën 03.06.1996 i është drejtuar njësisë rajonale të kadastrit në Mitrovicë, me të cilën ka kërkuar që prona që i është lënë nga baba i saj me kontratën për mbajtjen e përjetshme nr.246/89 të

regjistrohet në emrin e saj, në këtë kërkesë janë të përfshirë edhe dy vëllezërit e saj dhe motra e sipas kërkesës ia ka bashkangjitur edhe ekstraktet e lindjes.

Nga leximi i aktvendimit me numër 464-1720 të datës 02.07.1996, rezulton se S.M është tatim pagueuse e paluajtshmerisë që është objekt I kontratës për mbajtje të përrjetshme nr.264/89 në shumë totale prej 1.131 dinarë.

Nga leximi i Aktvendimit T.nr.83/2003 i datës 23.05.2003, vërtetohet fakti se procedura trashëgimore është pezulluar për shkak të mos ekzistimit të pasurisë, pasi që i ndjeri H.M pasurinë e paluajtshme që është dashur të shqyrtohet me kontratën për mbajtjen e përrjetshme nr.264/89 të datës 02.10.1989 e ka bartur tek S.M-Z.

Nga leximi i certifikatës së pronësisë UL-71208072-00027, vërtetohet se parcela kadastrale P-71208072-00578-2, figuron në emër të posedueses S.M, me pjesën prej 1/1 të pronës, në vendin e quajatur .. në sipërfaqe prej 148 m2.

Nga leximi i deklaratës së dëshmitares Q.S dhënë në seancën e datës 14.09.2017 pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë kishte deklaruar se H, babai im i ndjerë ka lënë katër fëmijë dy djem F dhe Sh dhe dy vajza mua dhe S, para se me ndërru jetë babai ka jetuar me S e di që Sh ka dalë nga shtëpia në vitin 1972 ndërsa F në vitin 1965. Unë e di që H.M gjatë jetës së tij ka lënë kontratën për mbajtjen e përrjetshme ku kemi shkuar në gjyq kemi qenë unë, motra S dhe babai im ku përronalisht e kanë nënshkruar kontratën mbi mbajtjen e përrjetshme, për kontratë kanë pasur njohuri edhe F e Sh.

Për festën e Bajramit kemi qenë prezent të gjithë ne motrat, dy vëllezërit, neset dhe dy dhëndurët gjersa ishim ne Sh iu drejtua S dhe it ha ta sjellë kontratën mbi mbajtjen e përrjetshme dhe ta çkyejë, babai u ngrit në këmbë reagoi dhe it ha jo S sepse ashtu e therriste nga dashuria, këtë kontratë kurrë nuk do ta çkyejë unë ta kam lënë ty edhe ko me të mbetë shtëpia e cila është në atë kontratë dhe pas fjalës së babait nuk ka reaguuar askush. E di që Sh dhe F disa herë kanë tentuar dhe kanë bërë presion dhe thjesht e maltretuan babain që ta çkyejë kontratën e shtëpisë që ia ka lënë S, mirëpo ai ishte shumë i vetëdijshëm se këtë nuk do ta bëjë kurrë. Pas këtyre fjalëve ne menjëherë kemi shkuar në shtëpi në M dhe i njëjti na tha që ma mos më leni kurrë vetëm sepse shumë më kanë maltretuar Sh me F. Deri ne momentin e fundit ët jetës për babain është kujdesur motra S, me të cilin ka jetuar motra S me bashkëshortin deri në momentin e fundit. Dua të theksoj se sa ishte në jetë edhe nëna e di që i pat thënë babait pasi që S po përrkujdeset për neve amanet po ta la shpinë me ia lanë S. Nëna si ka ndërruar jetë menjëherë pas pak kohe, babai ka shkaur në gjykatë dhe e ka përrpiluar kontratën mbi mbajtjen e përrjetshme.

Ndërsa lidhur me gjendjen shëndetësore të ndjerit H.M, dëshmitarja Q.S kishte deklaruar se babai im ishte mësues në rrethin e V, i njëjti gjer në momentin e fundit ka qenë në gjendje shumë të mirë s ai përrket veprimeve të tij mendore dhe qysh tani pas 20 viteve Shoqata e Vetërrnanëve të Arsimit në V ka ndarë mirënjohje ku në këtë solemnisht kjo shoqatë e ka ftuar motrën S dhe jo paditësin ngase e din edhe V edhe M që motra S është kujdesur për babain dhe nënën. Edhe pas luftës paditësit kanë dërrguar njerëz te Sabilja për prishjen e kontratës.

Nga leximi i deklaratës së dëshmitarit A.M, dhënë në seancën e datës 18.11.2020, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, rezulton se qysh në vitin 1982 kur isha shpërngulur në S jemi takuar me migjën H dhe e di që gjatë bisedës me ka thënë që shtëpinë ka me ia lënë S sepse ajo po më kqyr. Unë sa e di sa kanë qenë në bashkësinë familjare edhe F ka kontribuar në këtë shtëpi si me punë fizike ashtu edhe materiale, unë jam i bindur se sa ishin në bashkësi secili kanë kontribuar në mënyrën e vet të mundshme. Është e vërtetë se Sh e kqyr babën e vet dhe pikërisht në pushimoren e që e kishte Sh në J aty jemi takuar babain e tij dhe më tregoi se rastin sikur theksova më lartë dhe unë nuk kam njohuri se ai ka hequr dorë nga trashëgimia. Fjalët që mi tha H ishin në J se shtëpinë do ia lë S nuk i ka dëgjuar Sh nga se nuk ishte prezent por prezente ka qnë bashkëshortja e H tani e ndjera. Është e vërtetë se S është kujdesur më së shumeti për të ndjerin H dhe atë gjer në momentin e fundit të jetës së tij dhe më kujtohet edhe një fakt kur H pat thënë se S ende nuk është martuar dhe mos po mbetet pa u martuar dhe asaj do t'ia lë shtëpinë.

Paditësi Sh.M, në cilësinë e palës pranë, në seancën e datës 21.03.2024 deklaroi se unë kam qenë personi kryesor që jam kujdesur për babain dhe varrimin e prindërve të mi e kam kryer me shpenzimet e mia personale, në shtëpinë e babës, kam ndërtuar garazhën për kerr, për blerjen e shtëpisë sonë ka investuar vëllai im i madh dhe ka hyrë në kredi për blerjen e shtëpisë. Tutje padiësja në cilësinë e palës ka deklaruar se nuk i kujtohet ku është pavarësuar nga bashkësia familjare por deri në fund të jetës së babait të tij është kujdesur për të, i kam dërguar nëpër pushime në T, G me të gjitha shpenzimet e mia, asnjëherë nuk kam pasur contest me babën dhe nënën.

Tutje paditësi ka deklaruar se në vitin 1973 Qendra Medicinale ma ka dhuruar mua një banesë në rrugën .. aty kam jetuar deri në kohën e luftës vëllau im F ka banuar në një banesë në pjesën veriore të Mitrovicës, Q ka jetuar në shtëpinë e babës deri sa është martuar, S ka banuar në shtëpinë e babës dhe për 12 vite studime i kam ndihmuar unë në studime. Ndërsa nga viti 2002 kemi shkuar si turistë në Angli e më pas e kemi fituar azilin tani jetojmë edhe këtu edhe atje. Tutje paditësi kishte deklaruar se unë i kam ndihmuar babait tim, më duket se nuk e kam larë atë por nuk ka pasur nevojë unë i kam bërë punët e tjera, ndërsa i pyetur nga gjykata se kush e ka larë babain tënd paditësi deklaroi se nuk e dinte.

Ndërsa në fund paditësi deklaroi se babai ka qenë në gjendje të mirë shëndetësore, nuk më kujtohet nëse i njëjti ka pasur kujtesë të mirë.

E paditua S.M-Z, në cilësinë e palës në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 21.03.2024 deklaroi se në atë kohë babai im ka qenë duke punuar në Komunë dhe e kishte përgatitur kontratën mbi mbajtjen e përrjetshme dhe më ka thirrur mua ku kam shkuar së bashku me Q ku e kam nënshkruar kontratën mbi mbajtjen e përrjetshme, jam e sigurt se ju ka treguar sepse në prezencën time dhe të shumë personave të tjerë ju ka treguar në lidhje me kontratën për mbajtje të përrjetshme sepse ajo po kujdeset për mua.

Tutje e paditura në cilësinë e palës deklaroi se F është ndarë nga bashkësia familjare në vitin 1965, në vitin 1971 është martuar Q, në vitin 1972 është pavarësu Sh kështu që unë mbeta me

prindërit, nëna ka vdekur me 03.05.1989 ku pat lënë amanet që të sigurojë mua, menjëherë pas vdekjes së nënës babai në vitin 1989 lidhi kontratë mbi mbajtjen e përjetshme.

Unë jam martuar në janar të vitit 1990, disa vite kam jetuar me burrin mandej jemi kombinuar me motrën Q një javë ka shkuar ajo në shtëpinë e babës e një javë unë dhe jemi kujdesur për babën, djemtë e motrës janë kujdesur shumë për babën kanë fjetur tek gjyshi, unë jam kujdesur në atë mënyrë që i kam pastruar rrobat, shtëpinë, e kam shëtitur me veturë, babai nuk ka qenë i sëmure asnjë hap nuk e ka përdorur dhe kur ka pasur nevojë për kontrolla e ka kontrolluar Shaipi, babai ka vdekur me 24.04.1996 në M ku kemi qenë unë dhe motra Q dhe kur i është keqësuar gjendja i kemi lajmëruar edhe vëllezërit dhe kanë ardhur.

Tutje e paditura deklaroi se kontratën mbi mbajtjen e përjetshme e kanë nëshkruar në Gjykatë në veri e prezentë kishte qenë edhe motra e saj Q.

E pyetur nga i autorizuari i paditësit se a e kanë nëshkruar edhe zyrtarët e komunës, e njëjta deklaroi se sigurisht. Ndërsa në pyetjen e të autorizuarit të paditësit se a e kishte pyetur ndonjë herë babain se pse ta ka lënë ty shtëpinë, e paditur deklaroi se jo, sepse babai ka qenë i vetëdijshëm ska pasur nevojë ta mësoj pasi që ai e ka shitur arën për ta dërguar Shaipin në studime në ..., po ashtu edhe vëllait F. ia ka blerë një makinë për qepje.

Ndërsa në fund deklaroi se babai ka qenë plotësisht i vetëdijshëm deri në momentin e fundit pasi babai ka qenë mësimdhënës dhe ka pasur historian që e kanë pyetur babain për të kaluarën e popullit shqiptar duke shprehur qudi se i njëjti ka një memorie kaq të mirë.

Ligji i aplikueshëm

Duke qenë se kontrata për mbajtjen e përjetshme është vërtetuar me datën 02.10.1989, në këtë çështje civile juridiko aplikohen dispozitat e Ligjit mbi trashëgiminë me Nr.711-3 I datës 30.12.1974.

Ligji mbi Trashëgiminë i vitit 1974, në nenin 105 ka përcaktuar se “ *kontrata me të cilën një kontraktues obligohet të ushqejë për jetë kontraktuesin tjetër ose ndonjë person të tretë e në të cilin kontraktuesi tjetër deklaron se I lë tërë pasurinë e tij ose një pjesë të saj si trashëgimi nuk është kontratë mbi trashëgiminë por kontratë mbi tjetërsimin me shpërblim të gjitha sendeve të paluajtshme që i takojnë ushqim marrësit në kohën e lidhjes së kontratës ose të një pjese të caktuar të këtyre sendeve dorëzimi I të cilave ushqim dhënësit i është shtyrë deri në vdekjen e ushqim marrësit. Sende të paluajtshme konsiderohen edhe ato sende të luajtshme që shërbejnë për përdorimin dhe shfrytëzimin e sendeve të paluajtshme siç janë almiset, veglat bujqësore dhe bagëtia*”

Sipas kësaj dispozite rezulton se kontrata për ushqimin e përjetshëm, si kontratë e dyanshme, me shpërblim, është kontratë me të cilën marrësi I ushqimit deklaron se I lë tërë pasurinë ose një pjesë të saj dhënësit të ushqimit. Sipas kësaj dispozite rezulton se marrësi I kontratës e lidh këtë kontratë më qëllim të mbajtjes së tij dhe se pasuria e lënë dhënësit të mbajtjes I kalon në pronësi vetëm pas vdekjes së marrësit të ushqimit.

Në nenin 105 par4 të Ligjit mbi trashëgiminë, është përcaktuar se “ *Kontrata mbi mbajtjen e përjetshme duhet të përpilohet me shkresë dhe të legalizohet nga gjykata*”

Nga shkresat e lëndës rezulton se Kontrata mbi mbajtjen e përjetshme është legalizuar në Gjykatën e Mitrovicës me datën 2.10.1989 ku ka marrë numrin e legalizimit Nr.264/89, është vulosur dhe nënshkruar nga referenti I gjykatës.

Në nenin 106 të Ligjit mbi Trashëgiminë, është pacaktuar se “Ushqim dhënësi të drejtën e vet nga kontrata mund ta regjistrojë në librin public”.

Në nenin 108 të Ligjit mbi Trashëgiminë është përcaktuar se “palët kontraktuese mund të zgjidhin me marrëveshje kontratën mbi ushqimin e përjetshëm edhe pasi të ketë filluar ekzekutimi I saj. Në qoftë se sipas kontratës mbi ushqimin e përjetshëm kontraktuesit bashkëjetojnë dhe marrëdhëniet e tyre çrregullohen në atë masë sa që bashkëjetesa bëhet e padurueshme, secila palë mund të kërkojë nga Gjykata zgjidhjen e kontratës. Secila palë mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës në qoftë se pala tjetër nuk përmbush obligimet e veta. Në rast zgjidhjeje të kontratës secila palë ruan të drejtën që nga pala tjetër të kërkojë zgjidhjen respektivisht shpërblimin që I takon sipas rregullave të përgjithshme ë së drejtës pasurore”.

Në nenin 109 të Ligjit mbi trashëgiminë është rregulluar e drejta e ushqim marrësit në rast të rrethanave të ndryshuara si në vijim “ në qoftë se pas lidhjes së kontratës u janë ndryshuar aq shuë rrethanat sa që përmbushja e saj është vështirësuar shumë Gjykata me kërkesën e njëres se palës tjetër do ti rregullojë rishtas marrëdhëniet e tyre ose do ti zgjidhë duke pasur kujdes për të gjitha rrethanat. Gjykata të drejtën e ushqim marrësit mund ta kthejë në rentë të përjetshme në të holla, po që se kjo I përgjigje edhe njëres edhe palës tjetër”.

Ndërsa në nenin 110 të Ligjit mbi trashëgiminë është rregulluar mënyra e shuarjes së kontratës mbi mbajtjen përjetshme në rastin kur vdes ushqim dhënësi “ në rast se vdes ushqim dhënësi obligimet e tij kalojnë te bashkëshorti I tij dhe paslindësit e tij që janë të thirrur në trashëgimi po që se pajohen me këtë. Në qoftë se ata nuk pajtohen me zgjatjen e kontratës mbi ushqimin e përjetshëm, kontrata zgjidhet dhe ata nuk kanë të drejtë të kërkojnë shpërblimin për ushqimin e dhënë më parë. Në qoftë se bashkëshorti dhe paslindësit e ushqim dhënësit nuk janë në gjendje të marrin përsipër obligimet e kontratës kanë të drejtë të kërkojnë shpërblim nga ushqim marrësi. Gjykata këtë shpërblim do ta caktojë në baze të vlerësimit të lirë duke e marrë parasysh rrethanat pasurore të ushqim marrësit dhe të personave që kanë qenë të autorizuar për zgjatjen e kontratës mbi ushqimin e përjetshëm”.

Gjykata, gjen se kontrata mbi mbajtjen e përjetshme e lidhur në vitin 1989 ka pushuar së ekzistuari me vdekjen e marrësit të ushqimit edhe në mbështetje të nenit 359 të LMD-së së vitit 1978 i cili ka përcaktuar se “ me vdekjen e kreditorit- debitorit pushon detyrimi vetëm në qoftë se është lidhur duke pasur parasysh veçoritë personale të njëres palë kontraktuese.

Gjykata vlerëson se pretendimit i paditësit se kontrata mbi mbajtjen e përjetshme është absolutisht nule për shkak se e njëjta cenon pjesën e domosdoshme të trashëgimisë nuk qëndron sepse cenimi i pjesës së trashëgimisë nuk është paraparë me dispozitën e nenit 103 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 I cili përcakton se “ Kontrata që është në kundërshtim me parimet e përcaktuara me kushtetutë të rregullimit shoqëror, me dispozitat e detyrueshme

apo me moralin e shoqërisë vetëqeverisëse socialiste është nul , në qoftë se qëllimi i rregullës së shkelur nuk pasjellë ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në raste të caktuara nuk parashikon diçka tjetër”

Ligji Mbi trashëgiminë i vitit 1974 në nenin 28 ka përcaktuar në mënyrë decidive se cenim i pjesës së domosdoshme bëhet me anë të dhurimit dhe testamentit “Kur cenohet pjesa e domosdoshme, disponimi me testament do të zvogëlohet kurse dhurimi do të kthehet po që se ka nevojë të plotësohet pjesa e domosdoshme. Pjesa e domosdoshme cenohet kur vlefata e përgjithshme e deponimit me testament dhe e dhurimit tejkalon pjesën në dispozicion”.

Ligji mbi Trashëgiminë i vitit 1974 në nenin 29 ka përcaktuar se “Kur cenohet pjesa e domosdoshme më parë zvogëlohen deponimet me testament dhe nëse pjesa e domosdoshme nuk plotësohet në këtë mënyre atëherë kthehen dhurimet”.

Ndërsa në nenin 30 të Ligjit Mbi Trashëgiminë të viti 197 është përcaktuar se “Disponimet me testament zvogëlohen në të njëjtën masë pa marrë parasysh natyrën e tyre dhe vëllimin e tyre, dhe pa marrë parasysh a gjendjen në një ose më shumë testament po që se nga testamnetlënësi nuk del diçka tjetër. Në qoftë se trashëgimlënësi ka lënë disa leg dhe ka urdhëruar që ndonjë leg të paguhet para të tjerëve, ky leg do të zvogëlohet vetëm nëse vlefata legëve të tjerë nuk arrin për tu plotësuar pjesa e domosdoshme.”

Ndërsa në nenin 31 të Ligjit Mbi Trashëgiminë të viti 197 është përcaktuar se “Trashëgimtari me testament pjesa trashëgimore e të cilit duhet të zvogëlohet për tu plotësuar pjesa e domosdoshme mund të kërkojë zvogëlimin proporcional të legëve që ai duhet të paguaje po se se nga testament nuk del diçka tjetër. Po kjo vlen edhe për legatarin të cilin trashëgimlënësi e ka urdhëruar të paguajë diçka nga legu i vet.”

Gjykata vlerësoi pretendimin e të autorizuarit të paditësit në fjalën përfundimtare lidhur me cënimin e pjesës së domosdoshme dhe dispozitave ligjore të Ligjit mbi Trashëgiminë (të vitit 1974) gjeti se në këtë çështje civile juridike nuk kemi për objekt anulimin e testamentit apo kontratës mbi dhurimin, por kemi kontratën mbi mbajtjen e përjetshme e cila në asnjë rast nuk cenon pjesën e domosdoshme.

Tutje Gjykata rikujton të autorizuarit të paditësit se nenet 30 dhe 31 të Ligjit mbi Trashëgiminë përcaktojnë mënyrën e zvogëlimit të disponimeve me testament dhe kontratën mbi dhurimin dhe asesi kontratën për mbajtjen e përjetshme.

Gjykata konstaton se kontrata mbi mbajtjen e përjetshme, si kontratë e dy anshme, është puro personale dhe ka pushuar së ekzistuari me vdekjen e marrësit të ushqimit Hasan Mripa me datën 24.04.2006, ndërsa vërejtje rreth mos përmbushjes së kontratës nuk ka pasur nga marrësi i ushqimit e as kërkesë për zgjidhjen e kontratës.

Po ashtu paditësi edhe për nga koha nuk mund të kërkojë anulimin e kontratës për mbajtje të përhjetshme e cila është lidhur në vitin 1989, ndërsa marrësi i ushqimit ka vdekur me datën 24.04.2006, e padia në gjykatë është parashtruar në vitin 28.06.2011.

Gjykata me leximin dhe shqyrtimin e kontratës mbi mbajtjen e përhjetshme ka konstatuar se kontrata në fjalë nuk është lidhur në kundërshtim me rendin juridik, as me normat imperative dhe kështu, nuk përbën një kontratë nule siç e parashohin dispozitat e LMD-së së vitit 1978 që rregullojnë këtë çështje.

Paditësi me asnjë provë nuk ka arritur të vërtetojë që paraardhësi I tij, marrësi I ushqimit ka lidhur kontratën mbi mbajtjen e përhjetshme me të paditurën si dhënëse e ushqimit me qëllim të përjashtimit të trashëgimtarëve ligjore në trashëgimia.

Paditësi në këtë rast, nuk ka ofruar asnjë provë se kontrata nuk është përmbushur siç duhet, e as që ka të drejtë ta kërkojë zgjidhjen e një kontrate që tashmë është shuar, e një kërkesë e tillë për zgjidhjen e kontratës nga kjo palë, nuk përkon as me nenin 124 të LMD-së së vitit 1978 që përcakton se: *“Për kontratat dypalëshe kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e vet, pala tjetër mundet në qoftë se nuk është caktuar diçka tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushte parashikuara në nenet e më pastajme, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë në qoftë se zgjidhja e kontratës lind sipas vetë të drejtës, e sidoqoftë ka të drejtë t’i kompensohet dëmi.”*

Në bazë të kësaj, pala paditëse në këtë kontest, nuk është palë kontraktuese dhe nuk mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës kontestuese. Për më tepër, e drejta e një personi për t’u mbajtur nga dikush, sipas kontratës së lidhur (në këtë rast e drejta e paraardhësit të paditësit, si palë kontraktuese e kontratës kontestuese), është e drejtë personale që lidhet direkt me personin në fjalë, e që si e tillë, nuk mund të trashëgohet tek të tjerët. Kjo është edhe një arsye më tepër që tregon se kërkesëpadia e paditësit në këtë rast, nuk ka bazë dhe nuk mund të pranohet.

Në anën tjetër, as çështja e vënies së nënshkrimit nga ana e referentit të gjykatës, nuk dëmton formën e vërtetimit të kontratës e duke qenë se kjo e fundit është plotësisht ligjore, vërtetuar edhe nga vula e gjykatës e kontrata veç është përmbushur e është shuar, nuk ka asnjë rrethanë që mund të vërtetojë se kontrata ka pasur mangësi sa i përket pëlqimit të vullnetit të palëve. Për më tepër, mangësitë në pëlqimin e vullnetit të palës kontraktuese kanë të bëjnë me rrëzueshmërinë e kontratës, e jo me nulitetin absolut të saj. Në këtë rast, pavarësisht këtyre pretendimit të palës paditëse, nuk ka asgjë që e bën kontratën në fjalë as nule, e as të rrëzueshme. Ashtu siç u tha edhe më lartë, deri në vdekjen e paraardhësit të paditësit, si i mbajtur në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përhjetshme, nuk ka pasur kurrfarë ankese lidhur me përmbajtjen, formën apo ligjshmërinë e kontratës, ndërsa tanimë, për arsyet e cekura, paditësi nuk e ka të drejtën e kërkesës për zgjidhjen e kontratës, e as bazën juridike mbi të cilën do të mund t’i mbështeste pretendimet e veta.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, sa i përket shfuqizimit të masës së sigurisë ndalimin e tjetërsimit të paluajtshmërisë, kjo pasi që kërkesëpadia e paditësit është refuzuar në tërësi si e pabazuar, po ashtu i autorizuari i paditësit gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor

dhe as në fjalën përfundimtare nuk ka kërkuar nga Gjykata që masën e sigurisë të caktuar me Aktvendimin C.nr.129/11 të datës 21.02.2012, ta lejë në fuqi, madje nuk është deklaruar fare për këtë pjesë.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit në mbështetje të nenit 297 të LPK-së I cili përcakton se *“Garancia nga neni 297 i këtij ligji kthehet brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita në të cilën shuhet masa e sigurimit” në mënyrë që e paditura ta arrijë të gëzojë dhe të shfrytëzojë të drejtën e saj në mënyrë të lirë.*

Gjykata vendosi si në pikën e IV të dispozitivit të aktgjykimit në mbështetje të nenit 309.4 të LPK-së i cili përcakton se *“ Masën e Sigurimit të regjistruar në librat publikë Gjykata e fshinë kryesisht”.*

Gjykata vendosi si në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit në mbështetje të nenit 449 të LPK-së lidhur me nenin 452.1 të LPK-së I cili përcakton se *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore, si dhe tarifës së OAK-ës, andaj obligoi paditësin që të paditurës në emër të shpenzimeve të procedurës t’ia paguajë shumën totale prej 1,822.5 euro dhe atë për shpenzimet e gjykimit të kaluar shumën prej 1417.5 euro dhe atë për 9 seanca shumën prej 135 euro dhe kundërshtimin e datës 26.10.2011 në shumë prej 67.50 euro, për dy seancat e shqyrtimit gjyqësor të datave 03.11.2011 dhe 29.10.2013 nga 50% të shumës 135 euro (2x67.50) euro, ndërsa në emër të shpenzimeve të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur në rigjykim shumën prej 405 euro në emër të tri seancave gjyqësore nga 135 euro.*

Gjykata vendosi si në pikën VI të dispozitivit të aktgjykimit duke i refuzuar kërkesën për shpenzimet procedurale në shumë prej 675 euro si e pabazuar, pasi që i autorizuari i të paditurës në parashtrësën e shpenzimeve ka llogaritur nga dy herë seancat e datave 05.12.2013, 20.12.2016, 14.09.2017, 18.04.2018 dhe 29.10.2020, për të cilat shpenzime Gjykata ia ka njohur të drejtën e kompensimit në pikën e V-të të dispozitivit.

Gjykata në bazë të lartcekurave vendosi konform dispozitës së nenit 143 par.1 dhe 2 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-divizioni Civil
C.nr.926/21 dt.13.05.2024

G j y q t a r j a

Erolinda Uka Sadiku

Udhëzim mbi mjetin juridik: Ndaj këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme. Ndërsa për pikën II të dispozitivit të aktgjykimit palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 shtatë ditësh në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.